



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 27-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 04. 04. 2016 në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Vlora Limani-Hajnuni, Kryesuese
2. Labinot Shahini, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Agron Hajdini, anëtar
5. Arton Retkoceri, anëtar
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Burbuqe Fazliu, anëtar
8. Linda Shahini, anëtar
9. Xhevat Olluri, anëtar
10. Rizah Bajraktari, anëtar
11. Ukë Kryeziu, anëtar
12. Merita Zeqiri-Hajrizi, anëtar
13. Hajrije Salihu, anëtar
14. Blerim Gashi, anëtar
15. Adelina Krasniqi, anëtar
16. Florent Hoxha, anëtar
17. Petrit Kelmendi, anëtar
18. Lulzim Rrustemi, anëtar
19. Nazmi Krasniqi, anëtar
20. Enver Kozhani, anëtar
21. Feriz Hasani, anëtar
22. Ali Stublla, anëtar
23. Valbona Shillova, anëtar
24. Burbuqe Ilazi, anëtar
25. Vlora Buja, anëtar
26. Arben Bahtiri, anëtar
27. Edita Gashi, anëtar
28. Ramiz Qeriqi, anëtar
29. Zoran Çirkovic, anëtar
30. Xhavid Maholli, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës
2. Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBFsë

3. Fauz Xhemajli, Drejtor i Administratës
4. Rasim Hasani, Drejtor i arsimit
5. Basri Hashani, Drejtor i DRKS
6. Avdullah Fazliu, Drejtor i Shëndetësisë
7. Remzi Mehmeti, Drejtor i DSHM
8. Ilir Tasholli, Drejtor i DPU-së
9. Avni Olluri, Drejtor i DGJK
10. Heset Sahiti, Drejtor i DSHP
11. Latif Ramadani, Drejtor i DEZH
12. Imer Rustemi, Drejtor i DI
13. Ahmet Maksuti, zyra ligjore
14. Kimete Jashanica, përfaqësuese e OSBE-së
15. Qëndresa Jashanica, shefe e kabinetit
16. Bukurie Zejnullahu-Jashari, zyrtare për informim
17. Bekim Krasniqi, "YAHR"
18. Përfaqësues të OJQ "POLIS" (1)
19. Përfaqësuesit e mediave
20. Numër i konsideruar i qytetarëve
21. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
22. Bajram Zaskoku, përkthyes shqip-serbisht
23. Haki Avdiu , operator i zërimit

Proqesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Sami Murati**

Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 30 anëtarë nga gjithsej 31 dhe se ekziston kuorumi për punë dhe vendosje të plotëfuqishme hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë dhe kemi plotësimin e rendit të ditës me një pikë si vijon: Shqyrtimi i propozim Vendimit mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitin 2015 në vitin 2016, e gjithashtu te pika e pestë kemi ndryshim në titull ku thuhet zëvendësimin e anëtarit duhet të thuhet zëvendësimin e anëtarëve.

Pastaj pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime.

Xhevat Olluri, unë edhe në KPF kam propozu plotësimin e rendit të ditës e gjithashtu edhe sot kërkoj plotësimin e rendit të ditës me këtë pikë.

Shqyrtimi i ndarjes së shkollës së mesme proveionale "Adem Gllavica" në dy shkolla. Në KPF propozimin e kam bërë në emrin tim kurse tani ky propozim është në emër të grupit parlamentar. Në vazhdim përmendi arsyet se për çfarë duhet të ndahet kjo shkollë.

Rasim Hasani, Drejtor i DKA-së, tha se nuk është mirë që kjo qështje të hynë në rend ditës sot për shqyrtim meqë kjo qështje donë një analizë të thuktë dhe të shiqojmë se a i kemi kushtet me e ndarë shkollën profesionale. Në vazhdim tha se në këtë fazë ne duhet ta ndajmë gjimnazin në dy drejtime.

Hajrije Salihu, ndarja e shkollës profesionale "Adem Gllavica" është e domosdoshme dhe e arsyeshme. Unë mendoj se lokal ka mjaft por kuptohet se lokali duhet të meremetohet. Në fund propozoj që së paku kjo pikë të hynë në rend dite për mbledhjen e ardhshme.

Nazmi Krasniqi, është ide e mirë ndarja e shkollës profesionale dhe kjo ka qenë ide e kahershme por paraprakisht duhet të bëhet një analizë e pastaj të fillojnë procedurat për ndarje.

Xhevat Olluri, kërkoj që Kuvendi të voton propozimi e tij për plotësimin e rendit të ditës. Këtë po e kërkoj për shkak të rregullave të punës edhe pse e di se nuk do ta votojnë propozimin tim.

Arben Bahtiri, kam respektin për profesorin Xhevat por edhe ky nuk duhet të paragjykoj se kush voton e kush jo.

Ramiz Qeriqi, nëse kemi të drejtë, unë propozoj që të qitet në votim propozimi i Xhevatit.

Rasim Hasani, është një procedurë krejt tjetër ndarja e shkollës se shkollën e ndanë dikush tjetër e jo Kuvendi.

Florent Hoxha, në bazë të arsyeve që u dhanë unë propozoj që për mbledhjen e ardhshme ekzekutivi të përgatit për Kuvend propozimin për ndarjen e shkollës së mesme profesionale “ Adem Gllavica “.

Pastaj Kryesuesja vuri në votim propozimin e Florentit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për aprovoi propozimin e Florentit të cekur më lartë.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth rendit të ditës Kryesuesja vuri në votim rendin e ditës së propozuar së bashku me propozimin për plotësim me një pikë si dhe ndryshimin e titullit të pikës së pestë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, për kësaj seance miratoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 26-të e KK-së
2. Rregullore për taksat komunale
3. Propozim vendim për dhënien e pelqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan
4. Propozim vendim për anulimin e aktvendimeve 1Nr.464-833 dt.21.10.2009, 1Nr.464-833/1 dt. 14. 04. 2010 dhe nënkontratave të datës 22. 10. 2009
5. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB-së
6. Shqyrtimi i propozim Vendimit mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitin 2015 në vitin 2016,

Pas aprovimit të rendit të ditës Kryesuesja pyeti anëtarët se a ka dikush ndonjë pyetje.

Feriz Hasani, pyeti se kur do të ndahen shkolla e Gllgovcit.

Merita Zeqiri, pyeti se ndërtesat e banimit që lëshohen në përdorim a kontrollohen nga dikush se a i plotësojnë kushtet apo jo.

Pyetja e dytë është që në rrugën “Ramiz Shala” gjatë punimit të ujësjellësit kjo rrugë është dëmtu dhe askush nuk është duke e rregulluar.

Pyetja e tretë është se në lagjën e muhagjerëve në Bujari gjatë të reshurave kemi vërshime për shkak të mbylljes së urave dhe kërkoj që këto ura të hapen.

Florent Hoxha, kërkoj Jeta e Re të futet në Statutin e Komunës e gjithashtu edhe disa fshatra që teritorialisht i takojnë Lipjanit e janë me Graçanicë.

Pastaj pyeti se a është bërë ndonjë inspektim për ujin e pijes pas vërshimeve që kanë ndodhë. Në fund kërkoj që të mbyllet një gropë në rrugën “Qamil Olluri” e cila është hapur qe 3 vite e që këtë e kam kërku edhe më herët.

Ramiz Qeriqi, përmendi shqetësimin e punëtorëve të shtepisë së shëndetit në Lipjan

meqë në rrugën “Tahir Sinani” gjatë ditëve të tregut parkohen automjetet ku pengohet edhe ndihma e shpejt e shtëpisë së shëndetit, andaj kërkoj që të velen shenjat e ndalim parkimit të automjeteve në këtë rrugë.

Sheqetësim tjetër është e qytetarëve të lagjes Te Abeja ku në oborrin e fabrikës së Letrës është bërë një grumbull i mbeturinave nga kompania e Standard Benzi ku gjatë përpunimit të naftës apo vajit është duke kundërmua një erë e rëndë dhe kërkoj nga organet përgjegjëse që të merrë masa për këtë qështje dhe të njoftohemi në mbledhjen e ardhshme.

Shqetësim tjetër është për banorët që banojnë afër Xhamisë ku një qytetarë ka sjellë fotografite për gjendjen që është aty.

Linda Shahini, unë kam shqetësimin për shkak të zërit të madh të kafiterive e gjithashtu edhe kioska që është afër stacionit të policisë e cila shet CD-ja ku zëri i muzikës është shumë i madh dhe krijon përshtypjen se sikur je në dasëm.

Lulzim Rrstemi, unë kam një kërkesë që edhe më herët e kam përmend dhe kërkoj që në rend dite të Kuvendit të hynë edhe shqyrtimi i raporteve të komiteteve.

Burbuqe Ilazi, kërkoj që në rrugën e tranzitit që vjen në qytet të vëhet një pasqyre meqë në këtë vend është rrezik përmanent për aksidente.

Zoran Çirkoviq, komuna ka bërë ndriqimin publik në Grackë por kemi probleme për mirëmbajtjen e rrjetit të ndriqimit.

Te shkolla “B Aksiq” në Lipjan kërkoj që mundësisht të bëhet asfaltimi i rrugës meqë gjatë vërshimeve nxënësit kanë vështirësi nga uji të hyjnë në shkollë.

Në Grackë ka ndërtime pa leje e gjithashtu ka uzurpime nga ata të cilët kanë ardhur ku kanë blerë nga 10 ari e tani me uzurpime i kanë bërë nga 30 ari dhe është mirë që në këtë drejtim të mirren masa nga organet kompetente.

Nazmi Krasniqi, muaj më parë kemi pasur vërshime në teritorin e komunës së Lipjanit meqë rast janë shkaktuar dëme dhe është mirë që si Kuvend të kemi një raport se qfarë dëme janë shkaktuar dhe ku.

Ali Stublla, përmendi një pjesë të rrugës Dobratin-Sillovi ku për 20 metra kanë mbetur pa u shtru dhe kjo pjesë e rrugës krijon përshtypjen sikur të janë dy shtete.

Rasim Hasani, kërkesën për ndarjen e shkollës në Gllgovc e kemi bërë në Ministrinë për arsim mirëpo kur është caktuar lokacioni për këtë shkollë është bërë gabim meqë oborrine e shkollës e ndajnë dy rrugë, andaj kemi kërkuar nga Drejtorati i kadastrit që të paraqet propozim Vendimin për përmirësimin e këtij gabimi.

Heset Sahiti, sa i përket ujësjellësit që ishte pyetja ju njoftoj se gjatë vërshimeve në Poturovc është ndërpre furnizimi me ujë nga ujësjellësi për shkak se aty pusët kanë qenë të vërshuara. Sa i përket kontrollit të ujit sipas kompanisë së ujësjellësit uji qdo herë është nën kontroll. Sa i përket rrugës “Qamil Olluri” unë po ju them se nuk po kemi mundësi me i kry ato punë dhe se ky është obligim i kompanisë së ujësjellësit apo kanalizimit që në qdo ndërhyrje rrugën duhet ta kthej në gjendjen e mëparshme.

Ilir Tasholli, ishte pyetja nga Merita se a inspektohen objektet e banimit kur lëshohen në përdorim ju njoftoj se kjo është e rregulluar me Ligj dhe lëshohet qertifikata për banim në objekt.

Remzi Mehmeti, sa i përket pyetjes për fshatin Bujari unë ju them se nuk është i vetmi fshat por gjatë të reshurave probleme ka edhe në fshatra tjera dhe falë komunës që ka intervenu në hapjen e disa kanaleve apo urave pasojat kanë qenë më të vogëla. Mbyllja e kanaleve apo lumenjëve bëhet nga qytetarët e pandershëm të cilët hudhin mbeturina e gjithashtu disa ndërtojnë urat para hyrjes së tyre të cilat ura ndërtohen pa kritere, andaja është mirë që për të ardhmen të caktohen kriteret për këto ura.

Meqë pyetje tjera nuk pati u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 26-të e KK-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja, Vlora Limani-Hajnuni pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 26-të të Kuvendit?

Ramiz Qeriqi, në faqen 8-te të ekstraktit është thënë se unë nuk e di se ku janë ato tregje dhe krijohet përshtypja se nuk e di ku janë tregjet a unë jam i Lipjanit dhe e di por kam kërku që kompania t'i vendos pllakat te tregjet në mënyrë që të tjerët ta dijnë se ku janë edhe tregu i gjelbërt edhe tregu i kafëshve.

Xhevat Olluri, unë e kuptoj se kur janë fjalitë e gjata është e pamundur me i përfshi të gjitha por kështu qysh është fjalia del e pa kuptimtë. Në faqën 13-te te propozim Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtëshme kërkoj që të korigjohet meqë neni 6 paragrafi 1 pika 1 dhe neni 6 paragrafi 2 dhe 5 nuk i plotësojnë parimet dhe kriteret në shfrytëzim të pronës

Meqë vërejtje tjera nuk pati, Kryesuesja vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me të gjitha votat për të anëtarëve prezent

Aprovoi

Ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 26-të të Kuvendit me vërejtjet e dhëna më lartë

Shtesë: Ekstrakti.

II

Rregullore për taksat komunale

Lidhur me këtë pikë Kryesuesja e Kuvendit Vlora Limani-Hajnuni i dha fjalën Fauz Xhemajli, Drejtor i DA i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores si dhe me ndryshimet dhe propozimet për plotësim nga KPF-ja.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Xhevat Olluri, është për ta lavdëru punën që është bërë për këtë Rregullore, mirëpo unë kam bërë një propozim të amandamenteve dhe ua kam dërgu edhe juve Kryesuese edhe Drejtorit dhe në vazhdim lexoi amandamentet e propozuara për ndryshim të kësaj Rregullore.

Agron Hajdini, na para vetes kemi Rregulloren për taksa dhe qëllimi i komunës është që me këtë Rregullore të krijoj të hyra vetanake.

Me këtë Rregullore janë disa ndryshime në krahasim me Rregulloren e mëparshme.

Unë e kontestoj propozimin e Xhevatit kur propozoj 200€ taksë për rezervimet e parkimin e automjeteve për biznese.

Blerim Gashi, kjo Rregullore që ka ardhur sot është rezultat edhe i yni meqë kemi kërku disa herë këtë Rregullore ku janë bërë disa ndryshime nga Rregullorja e mëparshme.

U dhan disa propozime për ndryshim dhe plotësim por unë konsideroj se sot është vonë dhe unë e përkrahu si të tillë por kërkoj që qdo e hyrë sipas kësaj Rregullore të rexhistrohet.

Xhavit Maholli, Drejtori e tha që të hiqet fjala librat dhe unë kërkoj që mos të hiqet kjo fjalë por të thuhet shitja e librave lirohet nga taksa.

Ramiz Qeriqi, neni 9 pika 4 te qmimi 1m² për shitje të librave mendoj se është shumë qmim i lartë dhe unë kërkoj që taksa për shitjen e librave të hiqet.

Ahmet Maksuti, unë do isha nisë te neni 1 dhe 2 te qëllimi dhe objekti i rregullimit, qasjet juridike për hartimin të nenit 1 dhe 2 janë të ndryshme në shumë dispozita nuk përmendet qëllimi por drejt shkohet te objekti rregullimit dhe në këtë rast mendoj se profesori patë të drejtë se nuk është vetëm qëllimi i krijimit të hyrave por është qëllimi i përcaktimit të të hyrave për veprimet që kryejnë organet.

Te neni 6 ku është paraqitë fjala kërkesë nuk ka nevojë të thuhet paraqitjes së kërkesës. Në vazhdim lexoi propozimet e përgatitura me shkrim për ndryshim dhe plotësim të kësaj Rregullore.

Florent Hoxha, në takimet që kemi pasur jemi pajtu se ka vend për ndryshime dhe plotësime e kësaj Rregullore. Unë edhe në KPF kam dhënë propozimet e mija për plotësimin e kësaj Rregullore dhe po e përsërisë.

Në nenin 8 paragrafi 3 ku janë të paraparë për lirim nga pagesa e taksës për automjetet që i kanë në pronësi organizatat dhe shoqatat të cilat janë të regjistruara në pasusin e fundit ku thuhet anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve dhe të zhdukurëve të UÇK-së, invalidëve të luftës të shtohet pas fjalës invalidët e luftës, të shtohet veteranët e luftës dhe shoqatat e invalidëve civil, dhe martirët e luftës.

Te neni 11 paragrafi 4 parashihen gjoba dhe ky paragraf duhet të hiqet meqë kjo është rregullore për taksa e jo për gjoba, gjithashtu në nenin 13 paragrafi 3 ku bëhet fjalë për gjobë duhet të hiqet edhe ky paragraf.

Arben Bahtiri, përshëndes komisionin që ka përgatit këtë Rregullore mirëpo kërkoj që me këtë Rregullore të ngarkohen me taksa edhe bastoret.

Fauz Xhemajli, na jemi mundu që qdo propozim të dhënë ta inkorporojmë në këtë Rregullore por nuk kemi pasur mundësi me i përfshi të gjitha.

Te propozimi i Florentit te neni 11 që të hiqet pika e 4 kjo do të rregullohet me Rregullore tjetër dhe pajtohem që pika e 4 të fshihet.

Te neni 1 dhe 2 janë qeshtë parimore dhe nuk mund të ndryshohen.

Te neni 6 paragrafi 1 duhet të jetë fjala parashtrimi i kërkesave.

Te neni 6 paragrafi 2 duhet të shtohet fjala veteranët luftëtarë.

Te neni 7 të thuhet paragrafi 1 dhe pika 1.1,1.2, 1,3 e kështu me radhë.

Nazmi Krasniqi, si po shihet sot Kuvendi është shëndërru në komision dhe të gjithë anëtarët patën vërejtje, andaj unë propozoj që kjo Rregullore të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe të përgatitet për mbledhjen e radhës.

Agron Hajdini, ne në KPF e kemi shqyrtu këtë Rregullore dhe te shitësit e librit ambullant kemi thënë me i liru nga taksat dhe propozimi im është që ata shitës të librave me e marrë një vërtetim nga Komuna se janë të liruar nga pagesa e taksës dhe ata kanë të drejtë me shitë libra se jo gjith kush me shitë libra pa pas vërtetim për me shitë libra.

Vlora Limani-Hajnuni, meqë propozime tjera nuk pati konsideroj se propozimet që u dhan i kam përfshi si vijon:

Te neni 6 pika 1 te tabela të shtohet fjala kërkesat.

Te neni 6 pika 2 të shtohet fjala veteranët luftëtarë të UÇK-së

Te neni 7 te kërkesat dhe aktet zyrtare për të cilat nuk do të bëhet pagesa e taksës pika 1 nuk do të aplikohet taksa për kërkesa dhe vendime nëse me dispozita tjera nuk është përcaktuar ndryshe.

Pastaj te neni 7 paragrafi 1 të qëllohet pika 1 ndërsa te nën paragrafet ku janë vizat të qitët paragrafi 1.1, 1.2, e me radhë deri në fund.

Te neni 8 pika 3 të shtohet fjala veteranët luftëtarë të UÇK-së dhe martirët e luftës.

Te neni 11 të hiqet paragrafi 4 dhe te neni 13 të hiqet pika 3.

Këto ishin propozimet për ndryshim edhe nga profesori Xhevat edhe nga Florenti.

Pastaj vuri në votim propozimin e Rregullores së bashku me propozimet për plotësim të cekura më lartë dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për 1 apstenim miratoi Rregulloren për taksat komunale.

Shtesë: Rregullorja.

III

Propozim vendim për dhënien e pelqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Basri Hashani, Drejtor i DKRS i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Hajrije Salihu, ne jemi për ndarjen e këtyre mjeteve por kërkoj si kuvendar të kemi listën e 110 rasteve që ndahën mjetet.

Enver Kozhani, si grup parlamentar i PDK-se e mbështesim këtë propozim Vendim.

Basri Hashani, në vazhdimësi Bashkësia Islame e kanë sjellë listën për të gjitha rastet te zyra ligjore.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, asnjë kundër aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marjen e Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan në shumë prej **12.100,00€**, (dymbëdhjetë mijë e njëqind euro), për subvencionimin – mbulimin e shpenzimeve të varrimeve për 110 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur prej datës 28.10.2015 deri më 29.02.2016 me nga 110 Euro për secilin rast $110 \times 110 = 12.100$.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria ekonomike - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryetarit të Komunës për vitin 2016.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të Ministrisë të Administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

IV

Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, asnjë kundër aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR ZËVENDËSIMIN DHE PLOTËSIMIN E KATËR ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI –KKSB-së

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarëve të KKSB-së

1.Me këtë Vendim në pikën I të Vendimit për themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-3393 i datës 29.01.2014 zëvendësohen dhe plotësohen anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si vijon:

- 1.1 Në numrin rendor 3, caktohet **Xhevdet Bytyqi** në vend të Vehbi Gajtani nga Bashkësia Islame,
- 1.2 Në numrin rendor 4 caktohet **Serdjan Stanković** në vend të Gjorgje Stefanoviqit nga Kisha Ortodokse,
- 1.3 Numri rendor 5 plotësohet përkatësisht caktohet **Don Matej Palic** nga kisha katolike,
- 1.4 Numri rendor 12 plotësohet përkatësisht caktohet **Boban Jovanović**, kryesues i komitetit për komunitete.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSB-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-3393 të datës 29.01.2014.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së administrimit të Pushtetit lokal dhe publikimit në WebFaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

V

Shqyrtimi i propozim Vendimit mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitin 2015 në vitin 2016,

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Shkelzen Hajdini, Drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit.

Pastaj Kryesuesja tha se neni 4 i këtij Vendimi kur bëhet fjalë për hyrjen në fuqi të këtij Vendimi të harmonizohet me Ligj.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit, së bashku me propozimin për harmonizimin me Ligj të nenit 4 dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, asnjë kundër aprovoi këtë:

VENDIM

MBI DHËNJEN E PELQIMIT PËR BARTJEN E TË HYRAVE VETANAKE TË KOMUNËS SË LIPJANIT TË VITIT 2015 NË VITIN 2016

Neni 1.

Me këtë Vendim barten të hyrat vetanake në shumë prej **500.00€** që i përkasin vitit 2015 nga kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere:

-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej.....500.00€

Neni 2

Mjetet nga Neni 1 i këtij Vendimi barten:

-Zyra e kryetarit(160)Programi-16003 shuma prej.....500.00€

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në WebFaqen e Komunës.

Neni 5

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

VI

Propozim vendim për anulimine e aktvendimeve 1Nr.464-833 dt.21.10.2009, 1Nr.464-833/1 dt. 14. 04. 2010 dhe nënkontratave të datës 22. 10. 2009

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesja e Kuvendit, Vlora Limani-Hajnuni, i dha fjalën Avni Olluri, Drejtor i DGJK-së i cili njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Vendimit Pastaj Kryesuesja hapi shqyrtimin?

Feriz Hasani, na si grup parlamentar i PDK-së e përkrahim këtë propozim Vendim.

Xhevat Olluri, kemi të bëjmë me dy nënkontrata që nuk janë valide dhe si grup parlamentar e përkrahim këtë propozim Vendim.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati, Kryesuesja vuri në votim propozimin e Vendimit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, asnjë kundër aprovoi këtë:

VENDIM

PËR ANULIMIN E AKTVENDIMEVE 1NR.464-833 DT.21.10.2009, 1NR.464-833/1 DT.14.04.2010 DHE NËNKONTRATAVE TË DATËS 22.10.2009

Neni 1

ANULOHEM Aktvendimi 1nr.464-833 i dt.21.10.2009 për bartjen e të drejtës së transaksionit në shfrytëzim të paluajtshmërisë me të cilin investitorit N.T.P "Adriatik Commerce" nga Gjilani i është dhënë pëlqimi që nga ngastra kadastrale P-71409036-00164-21 me sipërfaqe prej 1.50,00 ha ZK Konjuh, t'i ndan nga 0.25,00 ha (gjithsejt 50 ari), Aktvendimi 1nr.464-833/1 dt.14.04.2010 për ndryshimin dhe plotësimin e aktvendimit 1nr.464-833 të dt.21.10.2009 dhe ANULOHEM nënkontratat e datës 22.10.2009 mbi shfrytëzimin afatgjatë të pronës së paluajtshme si në vijim:

-Ngastrën kadastrale P-71409036-00164-26 në vendin e quajtur "Branjesh" me kulturë arë e kl 4-të me sipërfaqe prej 0.25,00 ha të evidentuar në Certifikatën nr.289/2016 ZK Konjuh P.Sh.KK Lipjan shfrytëzues 99 vite "Bentokosi i Ri" dhe

-Ngastrën kadastrale P-71409036-00164-27 në vendin e quajtur "Branjesh" me kulturë arë e kl 4-të me sipërfaqe prej 0.25,00 ha të evidentuar në Certifikatën nr.289/2016 ZK Konjuh P.Sh.KK Lipjan shfrytëzues 99 vite BM BHK-BaU GmdH.

Neni 2

1.Anulimi i aktvendimeve dhe i nënkontratave si në nenin 1 të këtij vendimi bëhet për arsye se me aktvendimin 1nr.464-833 i dt.21.10.2009 i është dhënë pëlqimi N.T.P "Adriatik Commerce" për bartjen e të drejtës së transaksionit në shfrytëzim të paluajtshmërisë SH.P.K" Bentokosi i ri" nga Vitia dhe N.N.T."MASA-HE nga Gjilani, ndërsa me aktvendimin 1nr.464-833/1 dt.14.04.2010 për ndryshimin dhe plotësimin e aktvendimit 1nr.464-833 të dt.21.10.2009 është hequr N.N.T."MASA-HGE nga Gjilani si shfrytëzues i sipërfaqes prej 0.25,00 ha dhe e njëjta sipërfaqe i është dhënë shfrytëzuesit BM BHK-BaU GmdH e përfaqësuar nga Halim Krasniqi nga Klina në kundërshtim me nenin 8 par 8.4 të kontratës 1-464-159 dt.26.07.2006 në të cilën përkufizohet:

"Brenda afatit të realizimit të projektit (neni 5.2) nuk mund të bëhet asnjë lloj i transaksioneve pronësore ndërmjet investitorit dhe personave të tretë".

2. Nënkontratat e lidhura siq përcaktohet në pikën 1 të nenit 2 të këtij vendimi nuk kanë fuqi juridike ngase të njëjtat rrjedhin (burojnë) nga kontrata bazë 1-464-159 e dt.26.07.2006 për

dhënien në shfrytëzim të ngastrës kadastrale 00164-21 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 1.00,00 ha (një hektar) ZK Konjuh ish shfrytëzuesit N.T.P "Adriatik Commerce" nga Gjilani, e cila është shkëputur me Vendim të Kuvendit të Komunës së Lipjanit 15Nr.464-5843 të datës 01.02.2016.

3. Sipas gjendjes faktike në zonën kadastrale Konjuh SH.P.K "Bentokosi i ri" nga Vitia në ngastrën 00164-26 ka vendosur mekanizmin dhe mjetet që shërbejnë për prodhimin e betonit të cilat janë jashtë funksionit ndërsa BM BHK-BaU GmdH në ngastrën 00164-27 ka vendosur vetëm disa pjesë metalike (hekur) e që nuk kryejnë asnjë funksion për prodhimin e elementeve të betonit dhe laboratorjumi ashtu siq është përcaktuar me aktvendimin 1nr.464-833/1 dt.14.04.2010 dhe me nënkontratën e datës 22.10.2009, por kjo gjendje më shumë i ngjan një lloj deponie, njëkohësisht të dy nënkontraktuesit bazuar në informacionin me shkrim të lëshuar nga Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit nuk janë paisur me leje ndërtimore dhe dokumentet e tjera të nevojshme për ndërtimin e objekteve.

Neni 3

Obligohen nënkontraktuesit Shpk "Bentokosi i ri" dhe BM BHK-BaU GmdH që në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të kthejnë-lirojnë ngastrat kadastrale 00164-26 dhe 00164-27 në gjendjen siq kanë qenë më parë.

Neni 4

Obligohet DGJK-Sektori për gjeodezi dhe kadastër që të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për ndryshimin-heqjen e të drejtës së shfrytëzimit nga ish nënkontraktuesit SH.P.K "Bentokosi i ri" në ngastrën kadastrale 00164-26 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 0.25,00 ha të evidentuar në Certifikatën nr.289/2016 ZK Konjuh dhe BM BHK-BaU GmdH në ngastrën kadastrale 00164-27 në vendin e quajtur "Branjesh" me sipërfaqe prej 0.25,00 ha të evidentuar në Certifikatën nr.289/2016 ZK Konjuh, dhe t'i kthejë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri P.SH KUVENDI KOMUNAL LIPJAN.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Prokurimit dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

Pasi qështje tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 12,⁴⁴

Ekstraktin e hartoi
Sami Murati

Kryesuesja e Kuvendit
Vlora Limani-Hajnuni